

Prill 2026

BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

MINISTRI I DREJTËSISË ZHVILLON TRYEZA NDËRINSTITUCIONALE NË QYTETE KRYESORE PËR VLERËSIMIN E PUNËS NË SHËRBIM TË QYTETARËVE



Ministri i Drejtësisë, zoti Toni Gogu, zhvilloi përgjatë muajit Maj disa tryeza ndërinstucionale me degët e institucioneve të varësisë në Elbasan, Durrës, Berat, Korçë dhe Gjirokastrë. Gjatë takimeve u diskutua mbi rezultatet konkrete të punës së këtyre institucioneve në shërbim të qytetarëve.



SEANCË DËGJIMORE NË KOMISIONIN PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE MJETET E INFORMIMIT PUBLIK MBI ANALIZËN VJETORE TË PERFORMANCËS SË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS



Zëvendësministrja e Drejtësisë, znj. Elona Hoxha dhe Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, ishin ditën e sotme pjesë e seancës dëgjimore, mbi Analizën Vjetore të Performancës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për vitin 2025, në Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

NISJA E PRAKTIKAVE TË PAGUARA PËR STUDENTËT E DREJTËSISË, TË ANGAZHUAR NË OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Në një takim të zhvilluar pranë Ministrisë së Drejtësisë, me prezencën e Ministrit të Drejtësisë së Shqipërisë, zotit Toni Gogu, dhe prezencën e Ministres së Drejtësisë së Austrisë, zonjës Anna Sporrer, u lançua nisja e praktikave të paguara të punës për studentët e drejtësisë, të angazhuar pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.



TRAJNIM I ZHVILLUAR NGA AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE




Në vijim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të firmosur mes Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, u zhvillua trajnimi për stafin e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, lidhur me regjistrimin e punëkërkesve.



AKTIVITETE TË QENDRAVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

QSHNJP Tropojë, në datën 08.04.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve organizoi një takim informues me qytetarë pjesë të këtij komuniteti. Synimi i këtij takimi ishte rritja e ndërgjegjësimit për diskriminimin ndaj romëve dhe mbështetja e të drejtave dhe barazisë sociale.



QSHNJP Berat, në datën 21.04.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Drejtoria e Shërbimit Social Berat, mbi zhvillimin e shërbimeve sociale në këtë bashki.



QSHNJP Elbasan në datën 03.04.2026, zhvilloi një aktivitet pranë shoqatës MedPak, në kuadër të 2 Prillit, Ditës Botërore të Autizmit.

QSHNJP Elbasan në datën 21.04.2026, zhvilloi një aktivitet “Street Law”.



QSHNJP Elbasan në datën 22.04.2026, zhvilloi një intervistë për median e shkruar “Albania Express”.



QSHNJP Elbasan në datën 23.04.2026, zhvilloi një aktivitet informues, pranë Qendrës Komunitare Rome në Elbasan.



QSHNJP Elbasan në datën 24.04.2026, zhvilloi një intervistë për televizionin “Euronews”.



QSHNJP Shkodër në datën 22.04.2026, në kuadër të projektit “Qasje gjithëpërfshirëse për të garantuar akses të barabartë në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri”, mori pjesë në një trajnim për rritjen e kapaciteteve mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (PAK)

QSHNJP Shkodër në datën 28.04.2026, zhvilloi një takim me përfaqësues të OJF-së “Gruaja tek Gruaja”, znj. Blerta Nurja.



QSHNJP Shkodër në datën 29.04.2026, në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, dega Shkodër, dhe Qendrën e Parandalimit të Krimeve për të Mitur, zhvilloi një aktivitet informues me nxënës të Gjimnazit “Kolë Idromeno” Shkodër.



QSHNJP Shkodër në datën 30.04.2026, zhvilloi një takim me përfaqësues të Njësisë Administrative Komuna Rrethina, z. Gerald Hasaj, me qëllim ndërtimin dhe forcimin e bashkëpunimit në referimin e rasteve.

QSHNJP Tiranë në datën 16.04.2026, mori pjesë në një tryezë diskutimi të organizuar nga IFES dhe AHC, në kuadër të një workshopi konsultativ me organizatat e shoqërisë civile, me qëllim krijimin e një hapësire bashkëbisedimi ndërmjet institucioneve publike dhe aktorëve të shoqërisë civile.



QSHNJP Kurbin në datën 08.04.2026, në kuadër të 8 Prillit, Dita Ndërkombëtare e Romëve, zhvilloi një aktivitet, me fokus promovimin e barazisë dhe mosdiskriminimit si parime themelore kushtetuese dhe baza të shtetit të së drejtës.



QSHNJP Gjirokastër, në datën 01.04.2026, realizoi dy intervista me RTGJ/RTSH, me fokus ndihmën juridike, skemat e mbrojtjes sociale dhe ndërmjetësimin.

QSHNJP Gjirokastër, në datën 08.04.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve, në bashkëpunim me DHKN, Bashkinë Gjirokastër, QSHPLI, CSSP dhe shoqatën MKEZH, zhvilloi një aktivitet pranë tregut rom me pjesëmarrjen e komunitetit.



QSHNJP Gjirokastër në datën 15.04.2026, zhvilloi një aktivitet informues dhe ndërgjegjësues në Njësinë Administrative Lunxhëri, me fokus kategoritë vulnerabël dhe përfitimin e ndihmës juridike falas.

QSHNJP Gjirokastër, në datën 16.04.2026, në bashkëpunim me QSHNJP Përmet, zhvilluan një aktivitet informues në ambientet e Zyrës së Punës, Tepelenë.



QSHNJP Gjirokastër, në datën 28.04.2026, zhvilloi një intervistë me median Euronews Albania, me temë ndihmën juridike dhe platformën www.juristionline.al.



QSHNJP Gjirokastër, në datën 30.04.2026, mori pjesë në takimin e dytë të grupit të punës për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore për Bashkinë Gjirokastër, të zhvilluar në ambientet e Bashkisë Gjirokastër.

QSHNJP Dibër në datën 23.04.2026, zhvilloi një aktivitet informues në formën e “street law” me qytetarët e Bashkisë Dibër, në bulevardin qendror “Elez Isufi”.

QSHNJP Dibër në datën 29.04.2026, në bashkëpunim me Shoqatën e Personave me Aftësi Ndryshe dhe Personave që nuk shikojnë, Qarku Dibër, zhvilloi një takim informues në ambientet e kësaj shoqate në qytetin e Peshkopisë.



QSHNJP Përmet në datën 01.04.2026, zhvilloi një takim ndërinstytucional me përfaqësues të Komisarariatit të Policisë dhe Shërbimit të Provës në Përmet, me fokus diskutimin e problematikave që lidhen me rastet e dhunës në familje.

QSHNJP Përmet në kuadër të 2 Prillit - Dita Botërore e Autizmit, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues në bashkëpunim me Qendrën e Fëmijëve me Aftësi Ndryshe, me qëllim sensibilizimin e komunitetit dhe promovimin e përfshirjes sociale.



QSHNJP Përmet në datën 29.04.2026, zhvilloi një aktivitet informues me nxënësit e klasës XII-A të Gjimnazit Publik “Sami Frashëri”, ku u prezantua ligji për ndihmën juridike falas, duke i informuar mbi kategoritë përfituese, procedurat e aplikimit dhe shërbimet që ofrohen.

QSHNJP Vlorë në datën 09.04.2026, në kuadër të 8 Prillit, Dita Ndërkombëtare e Romëve, zhvilloi një aktivitet sensibilizues në terren pranë lagjes “10 Korriku”, ku është i përqendruar komuniteti rom





QSHNJP Vlorë në datën 28.04.2026, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, zhvilloi një takim në Bashkinë Selenicë, Njësia Administrative Kotë, me fokus promovimin e shërbimit ligjor falas dhe ndihmës juridike parësore dhe dytësore për kategoritë përfituese sipas ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.



QSHNJP Vlorë, në datën 29.04.2026, në kuadër të zbatimit të planit të punës për muajin prill, zhvilloi një takim pranë Shoqatës së Invalidëve.



QSHNJP Fier në datën 02.04.2026, në kuadër të Ditës Botërore të Autizmit, zhvilloi një takim informues dhe sensibilizues me stafin e “Qendrës së Zhvillimit”, Bashkia Lushnje.



QSHNJP Fier në datën 03.04.2026, zhvilloi një aktivitet informues pranë Njesisë Administrative Libofsh, Bashkia Fier, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ku u informuan qytetarët mbi kategoritë përfituese, procedurat e aplikimit dhe rëndësinë e aksesit në drejtësi.



QSHNJP Fier në datën 08.04.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga IRCA në bashkëpunim me Bashkinë Fier dhe aktorë lokalë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve, të zhvilluar pranë Shkollës “Dino Ismaili”, Levan.



QSHNJP Fier në datën 09.04.2026, mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar në Bashkinë Roskovec në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve institucionalë dhe aktorëve lokalë, ku u diskutua mbi bashkëpunimin ndërinstitucional.



QSHNJP Fier, në datën 15.04.2026, mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), me mbështetjen e Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit për drejtësinë gjithëpërfshirëse.

QSHNJP Fier, në datën 17.04.2026, në bashkëpunim me Qendrën “Epoka e Re”, në kuadër të projektit “Shëndet për Barazi dhe Siguri” të mbështetur nga AGORA, zhvilloi një aktivitet pranë Qendrës Shëndetësore Libofsh, me fokus rritjen e ndërgjegjësimit për identifikimin dhe referimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.



QSHNJP Fier, në datën 17.04.2026, mori pjesë në një aktivitet të zhvilluar në Shkollën “Jovan Ndreko” Libofsh, në bashkëpunim me Qendrën “Epoka e Re”, KMD dhe institucione të tjera të qarkut, ku u zhvillua një forum mbi parandalimin e kriminalitetit tek të rinjtë.



QSHNJP Durrës në datën 28.04.2026, në bashkëpunim me praktikantët nga universiteti “Aleksandër Moisiu”, morën pjesë në takimin e GTN dhe ETN.



QSHNJP Korçë në datën 01.04.2026, zhvilloi një takim me Shoqatën e të Verbërve Korçë, ku pjesëmarrësit u informuan mbi shërbimet e ndihmës juridike falas dhe u diskutuan problematikat kryesore me të cilat përballet kjo kategori.



QSHNJP Korçë në datën 01.04.2026, në kuadër të aktiviteteve të paracaktuara nga Drejtoria, zhvilloi një takim me Shoqatën e të Verbërve Korçë, ku pjesëmarrësit u informuan mbi shërbimet e ndihmës juridike falas dhe u diskutuan problematikat kryesore me të cilat përballet kjo kategori.



QSHNJP Korçë, në datën 08.04.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve, zhvilloi një aktivitet “street law” me fokus informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit rom mbi përfitimin e ndihmës juridike falas, ku pjesëmarrësit u njohën me të drejtat e tyre ligjore dhe procedurat për akses në shërbimet juridike, me qëllim rritjen e aksesit në drejtësi për këtë kategori.



QSHNJP Korçë, në datën 24.04.2026, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social, zhvilloi një aktivitet informues me përfitues të aftësisë së kufizuar, ku u prezantua ligji nr. 111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti”.

QSHNJP Korçë, në datën 29.04.2026, në kuadër të aktiviteteve të planifikuara nga Drejtoria, zhvilloi një aktivitet në Njësinë Administrative Pojan, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi shërbimet e ndihmës juridike falas dhe aksesin në drejtësi për kategoritë në nevojë.

QSHNJP Mat, në datën 02.04.2026, në kuadër të 2 Prillit - Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizmin, zhvilloi një aktivitet pranë Qendrës Ditore “Shpresa e Re”.

QSHNJP Mat, në datën 09.04.2026, mori pjesë në takimin e Ekipit Teknik Ndërsektorial (ETN) pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Mat, ku u diskutuan raste të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe u trajtuan disa raste konkrete të qytetarëve.



QSHNJP Mat, në bashkëpunim me Shoqatën “Shpresë për të Verbërit”, Dega Mat, zhvilloi një aktivitet informues ku u prezantua shërbimi i ndihmës juridike falas si një mekanizëm që garanton akses të barabartë në drejtësi për kategoritë në nevojë.

QSHNJP Mat, në kuadër të 8 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Romëve, zhvilloi një aktivitet “Street Law” në qytetin e Burrelit.



QSHNJP Mat në datën 27.04.2026, zhvilloi një aktivitet informues në shkollën 9-vjeçare “Tahir Hoxha” në Suc, Klos, ku u prezantua shërbimi i ndihmës juridike falas dhe kategoritë përfituese.

QSHNJP Lezhë në datën 03.04.2026, , zhvilloi një aktivitet në Njësinë Administrative Zejmen.



QSHNJP Lezhë, në të njëjtën datë, 03.04.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Down, zhvilloi një aktivitet “Street Law” me qytetarët, duke informuar mbi ndihmën juridike falas.

QSHNJP Lezhë në datën 08.04.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Lezhë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Komunitetit Rom.

QSHNJP Lezhë, në datën 08.04.2026, mori pjesë në një takim pune të organizuar nga OJF “Mary Ward Loreto” në Lezhë.

